



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 17

Prishtinë 14.07.2015., në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, kryetare, Agim Qeku, nënkryetari i parë, Mufera Sinik, nënkryetari i dytë, Saša Milosavljević, Čerim Bajrami, Rustem Berisha, Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Agim Kukaj, Fisnik Ismajli, Milka Vuletić dhe Danush Ademi,

Pjesëmarrësit e tjerë: vëzhguesi i OSBE- dhe Këshillit Konsultativ për Komunitete, menaxher i programit të Ambasadës Zvicerane.

Stafi mbështetës : koordinatori i komisionit dhe zyrtari i fushës

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković, kryetare e Komisionit

Për mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e

- 1. Miratimi i rendit të ditës ;**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe financa;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja – konstatoi se pika 1 dhe 2 të rendit të ditës janë miratuar pa vërejtje, kështu që filloi me shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe financa

Kryesuesja – duke marrë parasysh rëndësinë, mbrojtjen, vlerën dhe promovimin e legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës, veçanërisht të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për qendrën historike të Prizrenit, për formimin dhe funksionalizimin e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe dhe Këshillit Historik të Qendrës së Prizrenit, është e domosdoshme ndarja e mjeteve buxhetore për funksionimin e Këshillit, me qëllim të zgjerimit të kompetencave që i dedikohen Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Prizrenit. Në bazë të gjetjeve gjatë procesit të monitorimit të këtyre dy ligjeve që është duke vazhduar në kontinuitet nga viti 2014 nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, lidhur me çështjet e përcaktimit të rregullave për mbrojtjen, menaxhimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të Fshatit Hoçë e Madhe dhe Qendrës historike Prizren, si pronë e trashëgimisë kulturore dhe fetare nën mbrojtjen e përhershme me status të veçantë të zonës së mbrojtur, nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit (20 prill 2012, nuk janë zbatuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me funksionalizmin e buxhetit të Këshillit për shkak të mos ndarjes së mjeteve buxhetore.

Në këtë kontekst propozoi që Komisionit funksional t'i dërgojmë propozim për ndryshim dhe plotësim, nga se me të njëjtin sigurohet zbatimi i plotë në praktikë të Ligjit në fuqi, që është përcaktuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës si vlerë e shoqërisë multietnike Kosovare :

Organizata buxhetore e Ministrisë së Financave - kodi organizativ 201 nga kategoria „subvencione dhe transfere“ zvogëlohet shuma 58. 000,550 € dhe transferohet në tabelën 4.1 buxheti i reviduar për komunat e Prizrenit dhe Rahovecit në kodin 160 në Zyrën e kryetarit në kategorinë “Subvencione dhe transfere” për financimin e këshillave në vijim:

- *Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe në shumë prej 18.850, 000 €*
- *Këshilli për trashëgiminë kulturore të Qendrës historike Prizren në shumë prej 20.850,000 €, dhe*
- *Këshilli për zbatimin dhe mbikëqyrjen e „SNN“ në Qendrën historike Prizren 18.850, 000 €*

Qerim Bajrami: Komisioni funksional nuk e ka dhënë përkrahjen për këtë amendament, me arsyetim se ka mjaft mjete edhe për këto furnizime të ndara për MASHT, në kategorinë “Subvencione dhe transfere” në kodin 208. Ndërkaq, arsyetimi i MASHT është se ajo nuk është e obliguar të ndajë mjete për tekstet shkollore deri në klasën e IX.

Ministra për arsim obligohet që nga kodi 208 të financoj blerjen e teksteve shkollore deri në klasën e IX.

Ndërsa për blerjen e pjesës tjetër të teksteve shkollore për shkolla të mesme, ndahen mjetet nga Zyra për Komunitete pran Zyrës së Kryeministrit, nga kategoria “Subvencione dhe transfere” në të cilën zvogëlohet shuma prej 50.000€ dhe transferohen në MASHT.

Arsimi në gjuhën boshnjake, në kuadër të Ligjit dhe plan programeve të Republikës së Kosovës, ndonëse MASHT është e obliguar që t'i mundësoj tekstet shkollore për mësim, tashmë me vite mungojnë mbi 12.000 libra dhe të gjitha fletoret e punës deri në klasën e IX, duke filluar edhe abetaren për klasën e parë, ndërsa për shkollat e mesme mungojnë të gjitha librat në mësim në gjuhën boshnjake. Sipas MASHT arsyeja e mungesës është numri i vogël i ekzemplarëve të shtpur, veçanërisht për shkollat e mesme.

Tekstet shkollore në gjuhën boshnjake nga Bosnja e Hercegovina, janë kryesisht kompatibil me ato në Kosovë.

Në këtë kontekst propozoj që Komisionit funksional t'i dërgojmë propozim për ndryshim dhe plotësim si në vijim:

Organizata buxhetore Zyra e kryeministrit – kodi 104 nga kategoria “Subvencione dhe transfere” të zvogëlohet shuma për 50.000 € dhe të transferohet në kodin 208. Në organizatën buxhetore të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në kategorinë “Subvencione dhe transfere” për blerjen e teksteve shkollore nga Bosnja e Hercegovina për shkolla të larta, të mesme për mësimin në gjuhën boshnjake për nxënësit e komunitetit boshnjak në Kosovë.

Pas deklarimit lidhur me propozimet, Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Me shumicë të votave miratohen propozimet për ndryshimin dhe plotësimin në formë të amendamenteve të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe t'i dërgohen në procedurë të mëtejshme Komisionit funksional dhe Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Pregaditur nga: Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Živković